

**KALLËZIM PENAL**

**KALLZUES:** PARTIA DEMOKRATIKE DEGA FIER

**ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale, *Neni 248 "Shpërdorimi detyrës"*  
*Neni 328 "Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve"*.

**KUNDER:** [REDACTED] [REDACTED]

**DREJTUAR:** PROKURORISË PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE  
FIER

---

*I nderuar Z. Prokuror,*

Bazuar në nenet 280, 283 , si dhe neneve 248 e 328 të Kodit Penal, parashtrijmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

**I. LIGJI I APLIKUESHEM**

**1.1.** Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, dhe 283 parashikon se:

*Neni 280*

***Marrja dijani për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.*

*Neni 283*

***Kallëzimi nga ana e shtetasve***

*Çdo person që ka marrë dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*